



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 2

Rrogozhinë, më 24.02.2025 ora 12 : 00^{oo}

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës Njoftim, të thirrur nga Kryetarja e Këshillit Bashkiak, me shkresën nr.778.Prot datë 19.02.2025 me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.1, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 30.01.2025.
- 3- Shqyrtim i vlefshmërisë së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak z. Isa Halili.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2025 nga fondi i Bllok - Ndhmës 6%”.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2025 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 6- Raport mbi veprimtarinë e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” për vitin 2024 si dhe për aktivitetet e parashikuara për vitin 2025.
- 7- Raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Kullimit mbi masat e marra për sistemin e kullimit dhe vaditjes dhe gjendja e rezervuareve në territorin e Bashkisë Rrogozhinë.
- 8- Shqyrtim i problematikës së ndërprerjes së energjisë elektrike në Bashkinë Rrogozhinë.
- 9- Të ndryshme.
 - *Shqyrtim i kërkesës së znj. L. Rukaj dhe z. A. Bajraktaraj për hapje rruge në lagjen Elmadh, fshati Domen, Njësia Administrative Kryevindh.*
 - *Shqyrtim i shkresës së Komisarariatit të Policisë Kavajë për gjetjen e zgjidhjes së një konfliktit mes banorëve mbi zënien e rrugës së kalimit.*

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Mitat Daja, Altin Tosku, Gezime Met-hasani, Lulzim Hasa, Alime Hoxha, Enver Memolla, Fatmira Thartori, Erind Tosku, Mukades Gixhari.



Mungojnë :

Lije Dedej, Merilin Saraçi, Saimir Cani, Besnike Coraj, Isa Halili, Sokol Gosa, Lorena Baku, Renato Kalemi, Shpati Kolgega.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
3. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
4. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
5. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
6. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
7. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
8. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
9. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.
10. Olsi Dranga - Kryeinspektor i IMTV-së.
11. Astrit Thartori - Përfaqësues i Policisë së Shtetit.
12. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.
13. Sidorela Aliu - Specialiste e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përhëndetje të nderuar Këshilltarë ! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm për mbledhje e deklaroj zyrtarisht të hapur. Marrin pjesë në mbledhje z. Hekuran Xhani, z. Erind Tosku, znj. Fatmira Thartori, z. Enver Memolla, znj. Alime Hoxha, z. Lulzim Hasa, znj.



Gezime Met-hasani, z. Mitat Daja, z. Altin Tosku, z. Indrit Dedej, znj. Silvana Aliu dhe Mukades Gixhari. Gjithsej jemi 12-Këshilltarë.

Lexojmë Vendimet me karakter individual që u morën në mbledhjen e këshillit të datës 30.01.2025 të cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar janë si më poshtë :

Vendim nr .1. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr .2. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2025 nga fondi i pushtetit vendor.

-Lexojmë konfirmimin ligjor për vendimet e këshillit bashkiak me karakter normativ të datës 30.01.2025 të ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Vendim nr .3. “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit për përfitimin e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfitues nga sistemi i pikëzimit, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri 6 % nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën për vitin 2025.Konfirmohet në parim referuar VKM-së nr.597, datë 4.9.2019”.

Vendim nr .4. “Për krijimin e komisionit për programet e strehimit social”.

Konfirmohet referuar ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin. Prefekt Afrim Qëndro.

Mukades Gixhari . Tani të nderuar këshilltarë, para se të kalojmë në rendin e ditës keni të fotokopjuar përpara secili një projektvendim shtesë, “Për një ndryshim në Buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë të vitit 2025 për fondet e trashëguara”. Jeni dakord ta përfshijmë në rendin e ditës këtë projektvendim ? E hedhim në... ?

-Nuk miratohet përfshirja në rendin e ditës së projektvendimit me Nr.828.Prot datë 24.02.2024“Për një ndryshim në Buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë të vitit 2025 për fondet e trashëguara”.

Indrit Dedej . Të na i sjellin me zëra si i kanë shpenzuar.

Mukades Gixhari . Tani do kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës. Miratim i rendit të ditës. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 1 (një) e rendit të ditës .

Mukades Gixhari . Miratim i procesverbalit Nr.1, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë



30.01.2025. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet. Faleminderit.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 2 (dy) e rendit të ditës .

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 3, Shqyrtim i vlefshmërisë së mandatit të z. Isa Halili. Kjo është pikë të gjithë jeni në dijeni që është e mbartur sepse kemi disa mbledhje që e shqyrtojmë . z. Isa sot nuk ka ardhur, kryetari i komisionit të mandateve jo. Atëherë e lejmë për mbledhjen e radhës. Miratimi i “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”. Relaton drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Përshëndetje! Gjithsej janë 19 familje përfituese dhe fondi është 83 mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . E keni të gjithë dokumentacionin përpara. Ndonjë pyetje rreth kësaj pike? Ka ndonjë pyetje sugjerim. Atëherë e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 4 (katër) e rendit të ditës .

Vendim nr.5. Miratohet me 12-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me Nr.747.Prot datë 17.02.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2025 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%”, si dhe Relacionin Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.747/1.Prot datë 17.02.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 5, vazhdojmë po me z. Ledian Hasani për Miratimin e projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2025 nga fondi i pushtetit vendor”. Ndonjë pyetje? E hedhim në votim E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 5 (pesë) e rendit të ditës .

Vendim nr.6. Miratohet me 12-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me Nr .748.Prot datë 17.02.2025 ,“Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për



muajin Shkurt 2025 nga fondi i pushtetit vendor”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.748/1.Prot datë 17.02.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 6, Raport mbi veprimtarinë e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” për vitin 2024 si dhe për aktivitetet e parashikuara për vitin 2025. Raporton specialisti i sektorit të kulturës z. Endrin Ajdini. Përshëndetje z. Endrin.

Endrin Ajdini . Siç dihet nga raporti jeni informuar për aktivitetet që janë bërë për vitin 2024 dhe për vitin 2025 aktivitetet që do të bëhen. Një nga shtesat që do kisha për këtë vit do jetë dhe kostumet popullore që na duhen nga fillorja deri tek gjimnazi. Kërkojmë edhe një sistem tjetër fonie më të rregullt me pajisjet e veta edhe muzeu etnofgrafik i qytetit do bëhet ngjitur me bibliotekën, një dhomë tjetër që kemi parashikuar . Për sa i përket aktiviteteve i dini nuk është nevoja ti përmend.

Mukades Gixhari . Kush ka ndonjë pyetje për z. Endrin? Po znj. Alime Hoxha.

Endrin Ajdini . Këtë vit do bëhet plani për të vendosur sa do marrim gjithsej për kostumet popullore. Unë gjithmonë i kam kërkuar se janë në shërbimin tonë.

Altin Tosku . Atëherë kjo ka kaluar njëherë për kostumet.

Silvana Aliu . Si mund të më thuash ti mua që unë aktivitete të planifikuara kur ti nuk ke grup artistik? Festa e 1 Qershorit thjeshtë vjen mësuesja e klasës së parë ose mësueset e një shkolle marrin ambientin dhe ti thua që unë e kam aktivitetet . Për çfarë duhet të kesh fonde shtesë kur ti je i punësuar dhe thjeshtë i vjen në ndihmë. Aktivitet ju si qendër kulturore tuajën keni? A nuk mendoni që jemi në fazën e ndërtimit të një grupi artistik nga vetë i qyteti që të jetë i qytetit dhe të merret me aktivitetet? Derisa fondin e keni mos e çoni mos e vidhni e çoni...

Endrin Ajdini . Nuk vjedh njeri fondin...

Silvana Aliu . Po por këto janë aktivitete kot.

Indrit Dedej . Ti bësh vetë me një listë mbaji aty tek puna nuk ke pse i sjell në këshill bashkiak. E di për çfarë është këshilli bashkiak? Është që të miratojë ty këto që të marrësh fondin që ti përdorësh për aktivitete të ndryshme që ka pallati kulturës tënde. Nuk e kam personale por mos thuaj që ne nuk po kërkojmë fonde, me çfarë lekësh do i blesh kostumet? Aëherë pse tha që unë këtu nuk kërkoj fonde? Pse nuk e ke bërë kërkesën në bashki sepse është miratuar kostumet



bashkë me fondet pse nuk e ke realizuar? Këtë më thuaj pse nuk e ke realizuar? Ti mund të thuash që unë i kam bërë kërkesë bashkisë nuk m'i kanë dhënë, s'është realizuar këtë mund ta thuash pse nuk e thua? S'do ta thuash atëherë nëse nuk do ta thuash mos hajde fare këtu të kërkosht gjë, s'kemi nevojë ne as për planin tënd as për asgjë. Na thuaj pastër dhe qartë ne kemi miratuar buxhetin që kaloi ti pse nuk e ke realizuar thuaj urdhër bashkia nuk më jep, se ne këtë duam të dëgjojmë, ka për të marrë, se ne nuk jemi bërë për t'u tallur, populli nuk është bërë për t'u tallur. Kalo projektvendime rruga, kalo për kanale, këto hiç. Ti je në dijeni që kanë kaluar për kostumet, kanë kaluar që në 2023-2024 ne jemi 2024-2025.

Endrin Ajdini . Unë që kur jam aty i kam kërkuar kostumet mua më duhen, jo mua na duhen të gjithëve.

Indrit Dedej . Unë kaq po kërkoj, thuaj që unë i kam kërkuar nuk është realizuar nuk po ta vë ty fajin sepse është edhe mungesa jote që nuk bën kërkesa. Se prandaj i kalojmë këtu ose mos i sillni që ne të mos i kalojmë nëse nuk keni nevojë për ne. Bashkëpunimi ky është, ne e kemi bërë me dashamirësinë më të madhe edhe grupin artistik ti the që kemi bërë plane kam qejf që ta formoj, se ke arritur shumë bukur. Pastaj thua ti pse e kalon po ja fondet këtu të mbajtura, këtu të mbajtura po mos i kërkojmë ne ato nuk i sjellin fare këto të mbajturat i fusin dy letra fallso aty dhe harrohen siç janë harruar shumë gjëra tjera.

Enver Memolla . Në bazë të planifikimit që bën , mendon se janë të gjitha të realizueshme?

Endrin Ajdini . Aktivitetet?

Enver Memolla . Po.

Endrin Ajdini . Nuk e di a do realizohen të gjitha, unë shpresoj ti bëj të gjitha.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje tjetër për Endrin? Atëherë faleminderit për informacionin. Atëherë vazhdojmë me pikën 7, Raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Kullimit mbi masat e marra për sistemin e kullimit dhe vaditjes dhe gjendja e rezervuareve në territorin e Bashkisë Rrogozhinë. Relaton drejtori i bujqësisë, veterinarisë, pyjeve, kullimit dhe vaditjes z. Elton Xhani.

Elton Xhani . Përshëndetje të gjithëve! Është bërë përfundimi i kanalit kullues kanali i “Zogut” 2 km gjatësi, është pastruar kanali kullues me nr pasurie 701 me gjatësi 710 m që vazhdon nga rotondo deri në drejtim të pazarit. Është pastruar kanali kullues me nr pasurie 611 dhe 620 me



gjatësi 620 ml i cili i shërben kullimit të 30 ha tokë bujqësore. Është pastruar përroi i “Dedëve” dhe përroi i “Shimëve” me një gjatësi diku tek 70-130 ml. është pastruar kanali kullues me nr pasurie 100 me një gjatësi rreth 500 ml në fshatin Shardushk në drejtim të fshatit Greth. Është pastruar dhe betonizuar shkarkuesi i kanalit Peqin-Kavajë me nr pasurie 561 me gjërësi 250 ml. Dhe për sa i përket gjendjes së rezervuareve gjatë kësaj periudhe me shira të vazhdueshëm janë mbajtur në monitorim nga sektori i bujqësisë dhe aktualisht kuotat janë mesatare. Kanë nevojë për ndërhyrje tek pasqyra e brendshme e pllakave të betonit janë të mbuluara me ferra dhe shkurre, shkarkuesit katastrofik punojnë kur janë të mbuluara nga shkurret. Përsa i përket disa investimeve që ne kemi pasur në zonën e Lekaj është bërë pastrimi i kanalit kullues me nr pasurie 230 me gjatësi 790 ml dhe është pastruar kanali ujitës me gjatësi 520 ml dhe janë vendosur tuba në fshatin Luz i Madh. Është bërë pastrim i kanalit kullues me nr pasurie 324 me gjatësi 560 ml brenda fshatit Lekaj. Këto janë për sa i përket masave që janë marrë , kemi pasur dhe masa tjera që janë marrë për kanalet kulluese por ngaqë isha para dy muajsh prezent këtu . Tani kemi dhe disa masa tjera që jemi pranë për t’i marrë kanali kullues që është lëtu mbrapa tek lagjja Ballabanve është kanal kullues këtu ma ka referuar dhe Silvana. Pastaj do fillojmë dhe me kanalet ujitës por për shkak se jemi ...

Silvana Aliu . Nuk kemi as kryetar as nënkryetar nuk e di ku janë arratisur por ... atëherë për digën në Domen që kaluam atë projektin e kërkuar me ngulm e me kthim e me kthim, çfarë është bërë deri më tani? 8 muaj me bërë dokumentacionin?

Indrit Dedej . Je drejtor i të gjithë rezervuareve, si ka mundësi që u përmbyt Durrësi u përmbyt Shkodra u përmbyt Tirana? Ai rezervuari juaj, a u përmbyt?

Silvana Aliu . A doli , a rrezikon përmbytjen e fshatit?

Indrit Dedej . Ky problem nuk do mbyllet këtu se termi rezervuar Domen nuk ka. Termi Domen nuk ka, ndonjë term tjetër mund ta ketë, po mbaje në kontroll mos mbytesh fshatrat e Spillesë.

Enver Memolla . Tek Vija e Zogut që më në fund u pastrua kam vënë re që aty ka akoma tuba betoni të pa hequra. Pse nuk janë hequr? Nuk mund të rregullosh diçka dhe të prishësh diçka që është jetike, bashkë kemi takuar aty kemi qenë dhe thashë po nuk u bë kjo nuk kemi bërë asgjë the do ta bëjmë aty ishte skrepi e merrni në karrotrec e çoni e sillni sërish... Unë atyre fermerëve atje do ti kthej një përgjigje nesër që më thanë zotëri si do vadisim këtë vit? Këtë përgjigje dua nga ti. Kanali i ri që i themi ne fillon nga Karina kanali poshtë është në pronësi të Bashkisë apo të Bordit të Kullimit?



Elton Xhani . Në pronësi të bashkisë.

Lulzim Hasa . Në kohën e sistemit ne e njihnim rezervuari i fshatit Kazie, sot është lugina që ndan dy fshatrat Domen dhe Kazie është e vërtetë që diga e këtij rezervuari është shumë e amortizuar. Dhe poshtë kësaj dige këto fshatra që ishin lart kanë zbritur poshtë... mund të jenë mbi 100 banesa mund të jenë dhe disa hotele... Që rezervuari ekziston dhe shembja është e evidente as që bëhet fjalë. Është fshat i zhvilluar sepse ka një distancë nga deti të paktën 70-80 m është shumë afër. Ne ti kërkojmë llogari pse nuk e bëjnë jo pse nuk ekziston, jam banor i asaj i zone.

Altin Tosku . Aty në Sinaballaj është premtuar jo një vit por tre vjet rreshtë për një pritë.

Elton Xhani . Ta shohim.

Altin Tosku . Tre vjet ta shohim, nuk ke qenë ti ka qenë një tjetër, ti kur vjen si e merr ti deri këtu ishte tjetri ngre duart nuk i sheh fare letrat e para. Keni një gjë deri këtu jam këtej para duhet parë se këtej mbrapa çfarë është bërë nuk e di duhet parë pra. Edhe tek rruga tek Teqja ku është pazari kalojnë është rrugë që ditën e Shtunë kalojnë shumë njerëz, atje nuk shkëmbehen dot dy makina. E diskutuam herën që kaloi po do rregullojmë the dhe as tuba nuk hoqe në cep ... kanali është në dy krah nuk është një krah, si pastrohet këtej po këtej jo. E ka biznes ai, i merr taksë ti atij që ka tuba aty një shembull merr taksë? Njerëzit nuk kalojnë dot dmth do hapë sytë njëherë këtej njëherë andej se do kalojë një makinë jo dy. Bëni rrugën e pastroni dhe pastaj siç thotë Veri e hipni atë skrepin në karrotrec dhe e çoni në vend tjetër, e ke pasur skrepin aty.

Hekuran Xhani . Tani shpreh keqardhjen time për drejtuesit e bashkisë që sot nuk merr pjesë asnjë përfaqësues. Pra ne diskutojmë probleme që kanë të bëjnë me çëshjten e qytetarëve, por siç flasim ne këtu por ekzekutimi i këtyre vendimeve që marrim ne është në bashki, megjithatë ishalla nuk përsëritet herë tjetër. Lidhur me problemin e kullim vaditjes, buxheti i bashkisë i miratuar për vitin 2025 është 186 milion, 46 milion janë paga e shpenzime, 140 milionë janë investime, përkthimi i kësaj për 140 milionë për 500 lekë për metër sepse mjeti është i bashkisë nuk paguan mjet më por paguan vetëm naftën i bie me bërë 280 km kanal në çdo vit. Nuk po them 280 por të paktën të bëhen 150, kjo nuk është problematikë e këtij viti është një problem i mbartur ndër vite që kanalet janë kthyer në moçale dhe jo kanale keni parë vetë. Tani problemi qëndron duhet një organizim nga zyra e bujqësisë, çdo njësi administrative të marrë buxhetin e vet. Kemi punonjës në çdo njësi administrative, ku kemi agronom kemi financier, kemi urbanist kemi të gjithë specialistët pra taksapaguesit qytetarë Rrogozhinas paguajnë administratën e bashkisë administratën edhe njësitë. Nuk dua të abuzoj sepse çdo njeri që është në këtë zyrë por



me realizimin e detyrave dhe vendimeve që ne çka miratojmë këtu, i bie që ato nuk po e kryejnë punën ashtu si duhet. Dhe unë mendoj ndarja e këtij buxheti të bëhet nbi bazën e njësie administrative mbi një plan preventiv edhe ky plan unë dua të di sa milion lekë merr njësia ime Lekaj, sa km kanal bëhen këtë vit 2025. Sepse deri më tani unë i mora të gjitha këto , 80 ha kullon kanali i Zogut , 2 km , 0.790 m + 600 metra , 110 ha kullim pra kur bashkia Rrogozhinë duhet të ketë të paktën mbi 3000 ha tokë. Pra kemi bërë 110 ha kemi 3000 ha tokë si bashki. Si do ta realizosh ti planin ? Pra gjithsej janë bërë 4.75 km kanal edhe janë vënë në funksion të kullimit 110 ha po ja 150 ha tokë. Tani urgjentisht me ato specialistët tuaj thirrë sepse të jesh drejtor i bujqësisë, unë them dhe ato Agronomët që ndodhen në Njësitë Administrative, duhet të jenë jo në varësi të administratorit por në varësi të zyrës së bujqësisë në bashki, ku t'i jepen detyra por dhe ti kërkohet llogari. Edhe bëhet një farë preventivi edhe sa km ta dimë sa ka për të bërë vetëm fshati Luz si janë hapur dhe ato pritat e kullimit por janë dhe afërsisht dhe 50 km kanal vaditës që duhet bërë, nëse duam t'i shërbejmë fermerit në procesin e vaditjes. Prandaj unë them mbledhjen tjetër ti të na sjellësh një raport ne duke organizuar dhe specialistët e njësie administrative dhe ta dimë si do t'i shpenzojmë këto lekë. Sepse erdhi një projektvendim këtu që ne duhet ta fusnim në rend dite që unë isha për ta futur për vete në rend dite sepse nuk dua që asnjë qindarkë e këtyre taksapaguesve qytetarë Rrogozhinas të mos ngeli pa u shpenzuar. Tani për vendime kapriçoze jo se solli herët e solli vonë unë nuk jam, unë jam si ti shërbej më mirë qytetarit tim meqë më ka sjellë këtu si përfaqësues. Pra dhe njëherë zyra e bujqësisë unë dua të di muajin tjetër sa milion lekë nga 140 milionëshi ka njësia administrative Lekaj sa km kullues edhe do t'i ndjek vetë dhe sa vaditës do bëhen në atë. E nderuar kryetare mos e marr fjalën u bë bajat tre herë, në Luz të Madh po bëhet një investim edhe më e keqja e atij investimi mirë që u prish rruga ekzistuese shumë funksionale, tani ai projekt ka përfshirë vetëm gjysmën e Luzit. Unë mendoj që kur bëhet një projekt nga kushdo insitucion projekti në fshatin Luz gjysma u ka bërë gjysma mendoj që nuk ka për t'u bërë. Megjithatë ... është prishur asfalti nga... ka ardhur një investitor as nuk e di kam pyetur administratrin e njësisë administrative nuk e di, kam pyetur kryeplakun nuk e di. Ato filluan me skrepa atë farë asfalti rruga u ka bërë në 2008 megjithatë ajo mirë ajo kishte mundësi dhe të zgjerohej edhe me atë fond ne kemi shumë rrugë lagjeje në Luz që janë mbi 1 km rrugë që janë të pa asfaltuara, pra ai asfalt ishte hedhur atje për t'i shërbyer... Megjithatë pak interes kam por dua të di tan ai projekt kush e menaxhon, kush Bashkia, Qarku?

Elton Xhani . Ai është nga Këshilli i Qarkut ai projekt.

Hekuran Xhani . Është nga Këshilli Qarkut, kush e mbikqyr a e mbikqyr bashkia?

Tomorrr Thartori . Ka mbikqyrës privat.



Hekuran Xhani . E di si i thonë kësaj pronari i shtëpisë time, të vi të punonjë në baçen time. E kuptoni se kam marrë dhe administratorin , pronar në baçe jam unë vjen një dhe thotë po punoj në baçen tënde. Ato janë gjëra të filmuara, qytetarët sot nuk janë budallenj, është filmuar gjithë ajo rrugë duke u shkallmuar. Aty për mua ka shumë përgjegjësi penale këto njerëz unë nuk e di a kanë mend në kokë që ai SPAK-u po i thërret përditë? Apo këto do vazhdojnë të mbushin zyrat e SPAK-ut. Dakord investimet të shkojnë por ama të lejmë lagje të tëra pa rrugë të prishësh një asfalt mund të kishim kompletuar lagjet. Megjithatë i kërkoj bashkisë por kujt të ja kërkoj këtu përderisa nuk ka asnjë përfaqësues që ta mbikqyri të paktën ai investim të jetë serioz mos ngeli përgjysëm kjo ka rëndësi. Problem tjetër e nderuar kryetare ngrohja e nxënësve të shkollave, ato prondër aty fëmijët janë të gjithë me viroza edhe nuk ka dru nuk e di kush e mbulon arsimin por nuk ka dru sepse sot në mëngjes po më thonin ato disa nuk po i çojnë fëmijët se virozat po bëjnë punën e vet, shkolla Luz i Madh keni çuar dru? Unë sot në kafe në mëngjes më tha njëri që na u ftohën kalamajtë në shkollë se kam çuar, biles them dhe emrin se s'është sekret.

Alime Hoxha . Sot ishte drejtori i shkollës dhe nuk tha gjë.

Hekuran Xhani . Nejse problem i drejtorit. Tani kam një problem meqë kemi dhe një qytetar aty të bashkisë lidhur me zgjidhjen e konflikteve përpara se të futemi që mos e marr fjalën më vonë. Bashkia Rrogozhinë i ka të gjitha mundësitë kompetencat që i jep ligji për zgjidhjen e konflikteve, ky është një rast si të gjithë konfliktet tjera që ka kjo bashki. Një zyrë e posaçme ne e kemi të gjithë ku një zyrë ehe të presi qytetarët për hallet që ato kanë dhe po ajo zyrë të zgjidhë konfliktet dhe problemet. Shkon qytetari vjen 100 herë në Rrogozhinë për një gardh nuk ka një që jam unë kompetent për të vënë kufirin ku është gardhi. A funksionon ky pushtet a nuk funksionon? Njësia administrative zero funksion nuk është problem i madh se kështu i vret njerëzit, mirë qëlluan dy njerëz që nuk u morën vesh, po kush do mbajë përgjegjësi pra kjo bashki duhet të ngrejë dhe një zyrë për hallet dhe problemet që kanë qytetarët, si për konfliktet si për atë që ka probleme ekonomike të ketë një zyrë të presi tre burra tqë mirë dy gra një burrë të presi qytetarët për t'i dhënë zgjidhje. Ka njerëz që thonë kam fëmijët pa bukë sot, do lejmë pa bukë ne, ky është pushteti? Unë falenderoj gjithë këshilltarët se ju mora kohë shumë por kemi shumë probleme që duhen zgjidhur.

Silvana Aliu . Edhe ne xha Hekri kemi votuar që taksat e qytetarëve të shkopjnë aty ku duhet dhe nuk ishte kapriço e asnjërit prej nesh që ky projektvendim të mos futej në rendin e ditës ne e hoqëm nuk kemi informacion. Dhe në momentin unë nuk mund të vi të më thotë dy fjalë, kanë qenë lekët të na sjellin ku i kanë çuar pse kanë ngelur borxh dhe atëherë e kalojmë ne.

Hekuran Xhani . Këto janë lekë që nuk janë shpenzuar, këtu bëhet fjalë për lekë që kanë ngelur pa u shpenzuar në 2024...



Silvana Aliu . Po pse kanë ngelur?

Hekuran Xhani . Unë nuk e miratova vetë këtë. Unë nuk jam hetues, unë vi këtu dhe them atë 5-lekësh të ja çojmë qytetarëve tanë pa dallim partie bindjeje.

Silvana Aliu . Ty nuk po të vjen kryetari këtu, do çojnë ato fondin ku duhet.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me pikën 8, kemi këtë që është pikë e mbartur nga mbledhjet e mëparshme, Shqyrtim i problematikës së ndërprerjes së energjisë elektrike në Bashkinë Rrogozhinë. Të nderuar këshilltarë ju bëj me dije kam kërkesat që i kemi dërguar zotërinjve të Durrësit të OSHEEE-së dhe nuk na janë përgjigjur. Ne nuk do ndalemi do t'i dërgojmë prap për mbledhjen e radhës. Duam të respektojmë hierarkinë t'i marrim me shkallë.

Kalojmë tek të ndryshme, 'Shqyrtim i kërkesës së znj. L. Rukaj dhe z. A. Bajraktaraj për hapje rruge në lagjen Elmadh, fshati Domen, Njësia Administrative Kryevindh'. Drejtori i Politikave Urbane z. Tomorr Thartori.

Tomorr Thartori . Kjo është kërkesë që e ka trajtuar Njësia Administrative dhe IMTV-ja, rruga nuk është fare e zënë thjeshtë ka ferra shkurre, mjafton vetëm të hapet. Ankohen për gjë tjetër pastaj, kemi dy ankesa të ndryshme nga dy komshinjtë që kanë konfliktin , ankohen për pjesën e përbashkët që i ndan rruga është tjetër nuk ka lidhje fare me murin që ... Shiko rruga është lart mjafton vetëm të hapet, po pra konflikti është për gjë tjetër rruga është tjetër. Kanë qenë njësia bashkë me IMTV-në, rruga mjafton vetëm të hapet nuk është e zënë. Konflikti fillimisht ka qenë për avlli, ok vetëm do hapur do një skrep të hapet ta rregullojmë dhe kaq. Mitat ka qenë Njësia Administrative dhe IMTV-ja, një kërkesë shërbimeve për të çuar një skrep dhe rregullohet. Njësia jo ju.

Altin Tosku . Pse duhet të vinte në këshill direkt automatikisht e merr personi, shkon çon punëtorët pse duhet me ardhur në këshill sikur me qenë e zënë.

Enver Memolla . Fjala konflikt nuk është fjalë qejfi është fjalë e rëndë. Fakti që në Bashki janë dy kërkesa nuk është faji i këshillit bashkiak , fakt që vjen në këshill bashkiak është fakt ka rrugë nuk ka rrugë ka ferra ska ferra nuk zgjidhet me fjalë, zgjidhet me vepra atje ku është. Kam një vërejtje pse sot nuk është kryetari i fshatit Domen dhe Administratori i Njesisë që të dëgjojmë të dy palët se nëse çështja është në konflikt dhe tjetri në këshill bashkiak mund të jetë në konflikt me personin në fjalë mua më vë përballë faktit, them që qenka i njëjti konflikt si zotëria pas krahëve të mi, ka kaq vjet që... prandaj del vetëgjyqësia pastaj nga mosfunksionimi. Kompetencat e bashkisë kadastrës të marrin një grup pune të dalin në terren fakti është fakt dhe



të vazhdojë puna, duhet të zgjidhet me shtet, të zgjidhet me shtet halli që ka tjetri se nuk ka ardhur për qejf është fjala konflikt nuk është fjalë po luajmë futboll.

Mitat Daja . Tani çfarë zgjidhje do t'i japim këtij konflikti, të merret një vendim të hapet rruga të shkojë njësia administrative të hapet rruga.

Mukades Gixhari . Heqja e ferrave e zgjidh këtë problem meqë e paskan bllokuar?

Tomorr Thartori . Nuk është e bllokuar është thjeshtë shpat.

Indrit Dedej . Në radhë të parë ngrejmë komision këshilli se ka komision konfliktesh, ta kam thënë 100 herë edhe këtu duhet të marrësh pjesë ti që të shkosh njëherë të përballohesh njëherë si kryetare bashkë me grupin tonë dhe ndikon dhe atje dhe atje lart, ne jemi bashkë me zyrën e urbanistikës bashkë me policinë e shtetit shkojmë në terren. Aty verifikohet gjëja merret vendim edhe jepet për zbatim do policisë së shtetit do bashkisë së këtij këto nuk janë, këto kaq mundësi kanë.

Lulzim Hasa . Këto nuk janë me tokë me 7501 këto kanë blerë nga 300 metra. Konfliktet lindin kur dy veta kanë përfituar tokë nga 7501 që kanë konflikt kanë nga 10-15 dynym, këto kanë blerë nga 300-400 m tokë nuk është problem fare shko hap rrugën. Nuk është se ne dy kemi marrë nga 15 dynym dhe zihemi për një rrugë ato nga 300 m kanë, ku e gjetën rrugën ata, këto janë ambicie pse ky ka bërë dhe ... kjo është e thjeshtë.

Hekuran Xhani . Luli, ti si këshilltar bashkë me administratorin a je në gjendje ta zgjidhësh edhe kryeplaku i fshatit?

Lulzim Hasa . Ne jemi organ vendimarrës nuk jemi ekzekutiv, ne mund të shkojmë tëurveojmë si quhemi ne? - Quhemi vendimarrës nuk jemi ekzekutiv ne ta kuptosh drejt, ne jemi parlament nuk jemi qeveri. Unë po të jap argumentet se si qëndron ai nuk ka tokë 10-15 dynym dhe kanë zënë njëri tjetrin, ata kanë një tokë dhe e kanë për tangëllëk.

Hekuran Xhani . Jam dakord me argumentet po në rast se aty ndodh një incident se njerëzit janë vrarë për një pëllëmbë e jo më për 300 m.

Lulzim Hasa . Kjo do vullnet asgjë tjetër.

Alime Hoxha . Këtu thotë muri përbën një rrezik evident për çfarë muri bëhet fjalë, ku është?



Tomorr Thartori . Muri është në shpat.

Alime Hoxha . Ata kanë bërë murin para se të ...

Tomorr Thartori . Ka qenë.

Alime Hoxha . Thotë ka vendosur themelet e këtij muri përmes një punëmarrësi pastaj thotë... ky mur përbën një rrezik evident.

Erind Tosku . Pse duhet vendim që IKMT-ja të bëj punën e vet? Cfarë do bëjë?- Ta shqyrtojë ajo drejtori të vazhdojë punën e vet, ç'punë ka me ne? Ne nuk bëjmë gjë as me prishur avllinë, as me çuar IKMT-në, as me hapur rrugën asgjë, ne nuk bëjmë gjë.

Lulzim Hasa . Kjo është e zgjidhshme kërkohet një plan rievimi e ka këtë tokë ai nuk e ka këtë tokë është kollaj fare. Pronësia mbi tokën plani rievimit a e ka këtë tokë apo se ka këtë tokë dhe hiqet kollaj nuk ka asnjë lloj problemi. Mund ta kenë konfliktin që nga atje nga vijën.

Enver Memolla . Kryetare shkresa t'i përcillet drejtorisë përkatëse dhe të na japin një relacion çfarë kanë bërë për muajin tjetër. Të dalin në terren të bëjnë veprimin dhe i takon si takon çfarë është ... është shumë e thjeshtë.

Mukades Gixhari . Atëherë kalojmë në pikën tjetër, Shqyrtim i shkresës së Komisarariatit të Policisë Kavajë për gjetjen e zgjidhjes së një konflikti mes banorëve mbi zënien e rrugës së kalimit. Drejtoresha juridike dhe drejtori i politikave urbane.

Mitat Daja . Atëherë për këtë pikë ka qenë dhe disa kohë më përpara, kemi pasur dhe një diskutim në komisionin e konflikteve. Pavarësisht se komisioni është mbledhur dhe këtu ka qenë kryeplaku i lagjes , kanë qenë përfaqësuesit që kishin konfliktin me personat, ka qenë drejtori i urbanistikës në bashki dhe drejtori juridik. Është bërë një diskutim i gjatë për të gjetur zgjidhje dhe janë dhënë disa zgjidhje por askush nuk i ka pranuar zgjidhjet një nga këta zgjidhjet që unë i thashë zotërisë që bllokun rrugën Misir Gjinit një zgjidhje për të shuar një konflikt jo se i jepja zgjidhje ligjore kësaj pune. Dhe zotërinjtë kanë qenë aty që të gjithë. Të ç'mohet rruga se unë nuk merrem dot toka është e Misirit apo e dikujt tjetër këtë e vedos kadastra e vendosin organet tjera ligjzbatuese. Unë thjesht si kryetar i komisionit dhashë një zgjidhje për momentin thashë të ç'mohet rruga sa është rruga edhe të paguhet nëse kjo rrugë supozohet që është e tija, sepse këto kanë një konflikt të hershëm. Kjo gjë nuk u ra dakord as nga pala Misirit që ishte ai i cili e kishte ndezur këtë konflikt dhe as nga banorët. Dhe përfundimisht banorët njerëzit që ishin në konflikt



ranë dakord që çështjen ta çojnë në gjykatë dhe gjykata do e zgjidhte këtë lloj konflikti dhe në asnjë moment unë nuk kam kërkuar diçka personale nga banorët as nuk kam pasur dëshirë që ky konflikt t'u zgjeronte thjeshtë dhe nëse i kam thënë diçka nga vetja ime i kam thënë që konflikti t'u mbyllte. Kam diskutuar me drejtorin e urbanistikës ka thënë që ne nuk ndërhyjmë dot për dhënie servituti, i kam thënë bëni një plan rruge me qëllim që të miratohet nga këshilli bashkiak dhe bashkia ta dëmshpërblejë nëse është toka e tij gjithmonë se unë nuk e vendos se e kujt është toka. Të gjitha këto kanë qenë supozime që ja kam sugjeruar dhe në prezencën e banorëve dhe në prezencën e të gjithëve. Tani kjo ka qenë mundësia e zgjidhjes dhe gjithmonë edhe policia e shtetit e ka shkruar këtu dhe thotë : Kjo rrugicë pavarësisht që është tokë të vet ka shërbyer si rrugë kalimi për gjithë komunitetin e kësaj lagjeje prej vitesh dhe vendosja e gardhit nga ana e tij është e paligjshme e thotë policia e shtetit. Pasi prevalon e drejta e qytetarit për të hyrë dhe për të dalë në banesat e tyre apo të marrin shërbime shëndetësore. Pa dyshim që banorët duhet ta kenë rrugën është e pa diskutueshme dhe jemi munduar herë pas here që të gjejmë zgjidhje privatisht me anë kur kemi qenë komision nuk është gjetur zgjidhja. Dhe fjala e fundit ka qenë që ka shkruar në gjykatë dhe në gjykatë është urdhëruar mos bllokimi i rrugës, sipas fjalëve të banorëve. Unë kaq informacion kam për këtë dhe për sa i përket mbledhjes së këshillit të komisionit të konflikteve, unë këtu kam qenë dhe ditën e Premte për t'u mbledhur komisioni por se anëtarët e komisionit nuk vijnë në komision. Dhe unë çdo herë që ka pasur komisioni i konflikteve, ka pasur takim kam qenë prezent si kryetar i komisionit, dëshira e mirë është për ta zgjidhur konfliktin ndoshta nuk jemi të plotë që ta zgjidhim nuk kemi mundësitë dëshira është për ta zgjidhur konfliktin dhe të mos ketë konflikte, kush ka keqkuptime është mirë ti thotë ose të mi thotë privatisht ose të mi thotë dhe në publik nuk është problem. Dëshira është gjithmonë për ta zgjidhur konfliktin jo vetëm këtë por të gjitha konfliktet, unë kaq kisha për këtë rast pastaj tjerat i flasim.

Fatmira Thartori . Ne e kemi diskutuar njëherë këtë është marrë një vendim nga këshilli bashkiak që kjo të zgjidhet . Mitati ka qenë nga ana paqësore për ta zgjidhur këtë dhe e kemi caktuar ne ka qenë dhe vetë kryetari i bashkisë madje këtu që të gjendje një zgjidhje paqësore nga të dyja palët. Dhe ne që të gjithë këtu jemi për zgjidhje paqësore dhe jo të dhunshme megjithatë konflikti vazhdon. Ne i përsëritemi asaj pjeës së vjetshme se që të gjithë kemi qenë këtu që është marrë ai vendim që të gjejnë prap një zgjidhje paqësore. Edhe në qoftë se zotëria që bllokun rrugën ka dokumenta nga prap e bashkisë siç është vendosur vjet ti jepet një farë shume kështu kemi rënë dakord kemi qenë të gjithë këtu dhe kemi miratuar këtë pjesën. Kemi qenë këtu ne, kemi qenë të gjithë dhe në qoftë se nuk e ka zyrtare ... ne kemi qenë gjithmonë për zgjidhje paqësore të jepet e drejta e hakut nëse është me të ardhura financiare apo dhe pjesës që duhet patjetër të ketë një rrugë për të kaluar. Tani nuk është pjesë e këshillit bashkiak ose nuk është faji



i këshillit bashkiak që kjo zgjidhje nuk është bërë, ne i japim rrugën edhe këtë herë që të dyja palët të kenë marrëdhënie të mira sepse janë komshinjtë me njëri tjetrin.

Enver Memolla . Ta dëgjojmë dhe nga banorët shqetësimit që kanë.

Silvana Aliu . Thotë që ka banesën dhe jeton. E ka verifikuar policia?

Mukades Gixhari . Ta dëgjojmë z. Enver Gjini.

Enver Gjini . Për sa i përket këtij problemi ky është një problem i mbartur disa vjeçar dhe për këto disa vite për kohë të caktuara kemi dhe fotografitë të cilat i disponojmë çdo moment janë bërë fotografitë dhe duke menduar kjo zgjidhja paqësore s'jemi në Ukrainë këtu se jemi në Shqipëri dmth nuk ka fare... Këtu ka shtet ligjor dhe në qoftë se është pronë e zotërisë zotëria të gëzojë pronën prona është e shenjtë. Ama rruga kur e cila zotëria ka dy prona dhe këtu ai që ka bërë plan rilevimit shprehet , ne pretendojmë për rrugën nuk pretendojmë për pronën. Pronën ta gëzojë rruga ka qenë historike dhe për këtë rrugë 129 vjet tek ashiva është certifikata në vitin 1900 pa u bërë Shqipëria shtet i pavarur ka lindur gjyshi im ne kemi qenë një çati me zotërinë që pretendon për rrugën një çati gjyshërit tanë kanë qenë vëllezër kanë pasur një baba dhe ne jemi edhe bij xhajallarësh edhe se kanë marrë dy motra edhe bij tezesh. Zotërinjtë aty në atë rrugë ka kaluar gjyshi im ka kaluar gjyshi i zotërisë ja ku e ke këtu e kam marrë me 4.2.2025 tek arkiva në Kavajë në vitin 1930-1945 e në vazhdim dmth që ka të dhënat e sakta. Kjo rrugë ka qenë rrugë historike edhe është në hartë kam hartën e shkallës 1;5000 dmth nga viti 1990 e përpara që nuk është bërë asnjë lloj studimi urbanistik përveç atyre që kanë qenë dhe nuk është vetëm rruga jonë në anën që jemi ne të gjithë tani të nxjerrim plan rilevimit nuk ka rrugë i kanë suprimuar ndërsa harta që është me vulë të njomë me emrin e ish kryetarit Haqim Tosku bravo i qoftë nuk i ka bërë ai hartat por ka ruajtur dokumentet dhe Vezire Dedejit të gjitha dalin rrugët ku janë siç është në anën e djathtë dhe në të majtë siç është në rrugën magjistral që është rruga kryesore ka degëzime që shkojnë nëpër shtëpia. Dhe pasuria nr.205/66 është pronë shteti nuk thotë pronë e privatit e individit. Ne kërkojmë sqarime ose informacion për këtë pronë, na vjen policia ja ku është zotëria edhe ky nuk ka pasur informacion fare këtu me dhjetëra herë që në 2019 kur filloi pandemia filloi pandemia mendore përpara që njerëzit u çakërduan dhe filluan duke bllokuar rrugët. Ankohu në polici nuk kemi lënë vend në Kavajë polici tani edhe në media por sot ju faleminderit se e vunë ato në lëvizje komisariati i Kavajës e futët në rend dite ju faleminderit shumë që dhe po na dëgjoni dhe ne po sqarohemi se nuk po bëjmë këtu ndonjë luftë. Ai s'ka sqarim me datë 19.02 kanë marrë apo jo përgjegjës z. shef se ke thënë nuk kam informacion?

Fatmira Thartori . Zotëri fol me kulturë!



Enver Gjini . Po pra po më trego kulturën tani rri aty, për atë mbaj penalitet po ju drejtova atij do më tregosh ti! Një minutë ju lutem edhe nuk ka informacion jemi gjithmonë të karamboluar më shumë kam shkuar në polici këtu se kam shkuar tek punaime kur kam qenë në punë. Nuk kemi informacion na e sjellin është prona e x-it ne kërkojmë pronën 205/66 këto sjellin pronën 263/65 çfarë e ka ai ta gëzojë edhe kur shkonim nëpër institucione ne që kërkonim jo nuk është pronë e atij. Të lutem i thashë nuk po kërkojmë këtë ja ku është në hartë rruga ka dhe numër kadastral thotë pronari shtet, numri i pronës është shteti. Shteti e ka kanal e ka xhami e ka ujësjellës ku e di unë çfarë e ka kur të vijë shteti nesër që do ketë nevojë për zhvillimi urbanistik të prishi rrugët të na nxjerri në hënë. Dhe ne jemi drejtuar gjykatës të lutem në 2024, duke bërë dhe hartat , hartat nuk i bëj unë i ka bërë studio që është e licensuar siç i ka zotëria që m’i tregon faleminderit inxhinierit çfarë është zotit të urbanistikës dhe hartata kanë rrugën e kanë caktuar, jo po ke hyrë rruga tek Misiri. Kjo rrugë ka një mur avlli, avllia kam fotografinë këtu me parametra është bërë, kush e ka bërë këtë mur ne komuniteti? Se është muri pse është muri atëherë sdo kishte mur pse duhet të ngeli një kanal kur kjo pronë ky e ka deri këtu, ka ngelur kanal kjo këtu. Këtu nuk merret vesh, tani ka shitur pronën se nuk dua ti hy kësaj nuk kam punë me këtë kemi shkuar tani është çështja në gjyq, kanë marrë kryeplakun e ka pyetur prokuroria disponoj dokumentat këtu , të gjitha do jua jap që ti keni përpara që ti shikoni se do bëni procesverbal patjetër por po flas. Dhe është rritur aty kryeplakja Liri Gjini, Koni tani mbiemri, është rritur dhe si zotërinë si mua na ka njëlloj , rruga thotë ka qenë historike jam rritur aty thotë ka qenë rrugë kalimtarësh, rrugë që kalonte gjithë komuniteti dhe lagjja që është zhvilluar që janë bërë shtëpia të reja ku kanë lindur çuna e goca e ku e di unë nipër aty kanë kaluar. Kanë kaluar mjetet e ngarkesës që kanë qenë më përpara qerret edhe kafshët se kishim edhe kafshë. Tani pas 125 vjetëve që ka lindur gjyshi im vjen dhe bllokohet rrug. Në 2014 zotëria ka nxjerrë një tapi ku e di unë edhe pretendon për rrugën, tani mbivendosje janë bërë kudo. Mbivendosjet ngrihet një grup pune çfarë quhen ato që vijnë nga bashkia, këtu nuk funksionon asgjë , jemi ankuar me qindra miliarda herë , ai hidh inerte sill vinçat e kësaj ku e di unë ku i gjejnë vinçat harxho karburant , harxho taksat e popullit nuk e vejnë para përgjegjësisë kush je ti që hedh këtu këto inerte në komunitet. E para ç’është ky shkatërrim prone, e kujt është kjo pronë që shkatërrohet ky mur, se unë të bëj murin tim të shkatërroj paret e mia është çmenduri se nuk e ka të vetën se e ka shitur këtë pronë që në vitin 1992. Në 2002 zotëria që e ka pasur se ja nxiu jetën ja shitit tjetrit para noterit në Kavajë, në 2014 i kthehet dhe i merr pronën pa ditur gjë fare ai , ai është në Greqi kur ka ardhur është çmendur i merr pronën nxjerr tapi se 1992 s’ka pasur në 2005 filluan tapitë, çertifikatat po ke të drejtë më fal. Edhe ndërkohë kemi mbledhur se po më thotë po akuzoj, nuk po e akuzoj zotërinë kam respekt u mblodhëm ishte ajo që thotë populli “rrush pas të vjelave”, na mblodhën këtu ne ishim në çështje gjyqësore ne kemi menduar që atij ti jepet për këtë rrugë nga 100 euro shuma kaq nuk ka problem. I thashë më fal se nuk e di çfarë funksioni kryeni këtu thashë por kjo është e jashtëligjshme njëherë që qytetarët të blejnë një rrugë duhet që kjo rrugë në



kadastër të regjistrohet në emër të këtyre se është pronë e këtyre se po hedh paratë se kështu është gjetja e emëruesit të përbashkët. Atëherë këto tjerët që do lindin ato nipërit e asaj këtij që të vijnë nesër të blejnë një shtëpi ku do kalojnë jo e ka blerë ai se ka blerë ky jo po unë kam dhënë vetëm dy por çunat tuaj të kalojnë ku të duan. Pse anarshi gjithë jetën në shek. XXI, dekada 3-të , shteti hap rrugë ku nuk ka rrugë, çfarë tha aia zotëria atje kanë blerë kanë nga 300 m se e dëgjova shumë mirë dhe ai gëzon të drejtën ta blejë pronën e gëzon të drejtën të kryejë funksionet në rregull të jetës së tij vetëm në Shqipëri ndodh ky fenomen jemi zënë me inspektorin. Edhe detyrimet që kam paguar nga viti 2012 , se atëherë kanë filluar se përpara nuk ashtu ato 2012 përpara kur kemi nxjerrë tapitë kam tapitë të gjithë këtu urdhëro është paguar detyrimi që nuk e merrte bashkia e merrte hipoteka atje nga kjo deri në 2024 urdhëro dhe librezën, çfarë kërkon këtu? Ai që pretendon mirë që ka pronë nuk ka paguar detyrime ç'është ky shtet që nuk i ve këto njerëz para përgjegjësisë edhe pretendon... hajde paguaj pak detyrimet pastaj zgjidhet dhe çështja nuk ka ngelur më mirëkuptim është në gjyq. Të japë verdiktin gjyqi thotë shprehet prokuroria këtu thotë deri se shih çfarë bëjnë këta ne thamë kallzim se kështu funksionon këtu prandaj këtu duhet të çmendesh. Të shikosh fotografitë as në Kandahar më fal as në lindjen e mesme nuk është ky tmerr që t'i shikosh fotografitë inerte por gjigande jo inerte janë ngritur me vinç inertet se nuk ngriheshin dot . Shembi shtëpinë e huaj dhe i hidhte inertet nga inati bllokonte rrugën . Ky zotëri dhe thotë atje thotë nuk gjejmë elementë të veprës penale për ta dënuar për vetëgjyqësi që nuk janë thelluar fare e kanë fajin OPGJ-të ma merr mendja se nuk kanë çuar materialet që i kemi dhënë ne fotot duke reduktuar se unë shqiptar njoh këtë ky njohe këtë se jemi popull i vogël edhe njihmei në fakt mirë bëjmë të zbuten gjërat se s'kam qëllim u dënua ky apo ai dhe po fitojmë gjë, ne duam të zgjidhim problemin jo të dënojmë të penalizojmë njerëz. Por duke ndjekur rrugën ligjore quhemi o injorantë o frikacakë o më fal çfarë të them unë jashtë këtij planeti. Të kryesh vepra të dhunshme penale quhesh kriminel, po tani ka një durim na u bë shtëpia ferr ta marri me gjyq ta marri dhe të marrë dhe shtëpinë time unë nuk kam çfarë e dua shtëpinë pa rrugë me rre i them ta gëzosh. Një minutë më fal atje janë 17 -familje, jo 7-familje me përgjegjësi penale çdo se janë kurorë më vete, janë 24 fëmijë përveç fëmijëve të mi se më kanë ikur nuk me kanë futur se nuk kam si ti fus kur nuk i kam këtu, që shkojnë nëpër kopshte nëpër çerdhe më fal edhe në shkolla 24 fëmijë. Ku kalojnë këto?- Kalojnë sipër gurëve e ferrave. Brenda muajit nga data 25 Janar e deri më datën 14 , 4-herë ja ku e kam këtu 4 herë e ka bllokuar rrugën e kam me data, nga data 19 ka qenë e Mërkurë deri më sot rruga është e bllokuar me gurë me ferra hajde është atje. Edhe mashtrojnë i thojnë komisariatit kur kërkon informacion i thonë zotëria disponon tokën bujqësore të cilën e ka me certifikatë dhe atje në atë tokë ka ndërtuar një shtëpi thotë ku banon me familjen e tij , atje nuk ka as gurë as mur. Po pati atje në atë ngastër toke atje sipër unë mbaj përgjegjësi këtu para të gjithëve ju, dmth jo përgjegjësi administrative por penale. Nuk e dimë çfarë të bëjmë unë jam 72-vjeç , ku kam kaluar unë 72-vjet se po çmendem. Ju faleminderit shumë.



Enver Memolla . Është hera e disatë që vjen kam një pyetje dhe për pjesën e bashkisë çfarë masash janë marrë këto ditë?

Enver Gjini . Asgjë është bllokuar rruga.

Enver Memolla . Nga ana juaj, ana juridike që keni ndjekur?

Tomorr Thartori . Harta 1;2500 xhaxhi Ver, hartën e hipotekës dua unë, nuk ka rrugë në hartë se normalisht rruga mbivendosje krijon se po nuk pati në hartë. Po shumë bukur ku është rruga në hartë ?

Enver Gjini . A është hartë me vulë të njomë kjo? A është hartë e dukshme a është hartë e qartë, ja ku e ka rrugën shikoni rrugën mund të bëhet një gabim pse gabimin do mbroni ju?

Tomorr Thartori . A punojmë me hartën e hipotekës ne?

Enver Gjini . Ja ku e ke hartën këtu.

Tomorr Thartori . Po me çfarë punoj unë, krijoj harta unë?

Enver Gjini . Mos krijo harta ja ku është harta.

Tomorr Thartori . Janë prona private zgjidhjen servitutit detyrues e jep gjykata nuk e jep as bashkia. Kemi bërë aplikim nuk na ka kthyer përgjigje hipoteka, kam bërë aplikim të tregoj aplikimin. Kodi civil neni 265 pronari njuh pronën në bzë të ligjit, ka të drejtë ti kërkojë pronarit tjetër kufitar servitut rrugë kalimi në mungesë të një mosmarrëveshjeje nuk merren vesh njëri me tjetrin . I kemi takuar disa herë i kemi takuar tek bashkia nuk pranon zotëria atëherë pronari mund t'i drejtohet gjykatës ky është ligji. Çfarë zgjidhje ti japim ne?

Enver Memolla . Meqenëse çështja është në gjykatë ka të drejtë ta ndërpresë rrugën?

Enkela Ballabani . Ka patur një vendim gjykate për sa i përket sigurimit të padisë që kërkonin përveç se mos cënimin e servitutit të drejtës së kalimit ka pasur edhe sigurim padie që kanë kërkuar zotërinjtë qytetarët, që pretendonin se i zihej rruga e kalimit. Gjykata me vendimin që ka marrë të datës 30.04.2024 e ka rrëzuar kërkesën për sigurimin e padisë të qytetarëve. Ndërkohë çështja për sa i përket cënimit të servitutit është në dijeninë time të paktën nuk është... Këtë vendimin që kam unë ma dha zotëria nga komisariati.



Enver Gjini . Ne kemi bërë se kam bërë unë e kanë bërë të tjerët kallëzim penal për vetëgjyqësi. Vetëgjyqësi kush quhet zonjë? Kur bllokohet rruga ... bllokimi privimi i lëvizjes së njerëzve është një vepër tjetër penale , bllokimi i mjeteve të transportit ambulancës të zjarrfikëses etj të cilat duhet të futen në komunitet , për emergjencat është vepër penale tjetër. Dhekur e kanë çuar se nuk e ma bërë unë kanë bërë kallëzimin si kanë futur materialet aty është inspektori i zonës se ka bërë ai e kanë bërë tjerët se do e kërkojmë dhe kur e kanë bërë nalizëm thonë nuk kemi gjetur elementë të veprës penale për vetëgjyqësi edhe bie detyrimisht dmth nuk ka rrezikshmëri.

Tomorr Thartori . Për sigurim padie që ruga të ishte e pacënueshme deri në vendimmarrjen .

Enver Gjini . Është bllokuar rruga është bllokuar nga data 19 paradite kemi bërë dhe kallëzim prap tjetër në polici me datë 20 ikin kallëzimet shkojnë në veshin e shurdhër prandaj ikin këto të rinjtë nuk rregullohet unë 72-vjeç e ndjej veten në bela më kanë ikur 22 vetë vetëm nga familja ime çfarë është kështu? Është edhe sot e bllokuar edhe sot që flas unë po nuk ishin ferrat dhe gurët atje të më pështyni mua më merrni për veshi ore plak matuf më thoni. Hapjen e rrëgës derisa të mbaojë procesi gjyqësor ta marri.

Tomorr Thartori . Ky quhet sigurim padie merret në gjykatë.

Indrit Dedej . Unë jam nënkryetar i komisionit nuk jam njoftuar.

Tomorr Thartori . Tani mua ma kanë sjellë me ftesë nga bashkia.

Indrit Dedej . Kush ta ka sjellë ftesën? Me ftesa fallso të atij atje? Unë jam nënkryetar i komisionit të konflikteve kush më ka lajmëruar mua? Unë kam kërkuar 100-herë. Unë kam kërkuar të ngrehet komision nga këshilli bashkiak.

Mitat Daja . Unë kam thënë që ju keni të drejtën e juaj dhe është e drejtë ajo , unë nuk e imagjinoj dot si mund të bllokohen 17- familje po ne jse. Pasi kemi diskutuar këtu 1000 zgjidhje ju jeni dëshmitarë që kam dhënë dhe zgjidhje private kam thënë do ta zgjidh në mënyrë private për të bërë paqe se ligjërisht kishte gjëra tjera. Më ke thënë që e kam zgjidhur këtë problem kemi qenë tek dyqani duke e bërë padinë në gjykatë, sepse kjo ishte rruga sipas asaj që pashë unë kjo ishte rruga e vetme për t'u zgjidhur në mënyrë ligjore se tjetër rrugë nuk kishte. Tani puna është që gjykata e ka rrëzuar sigurimin e padisë.

Enver Gjini . Unë do shkoj të bëj një padi në gjyq nuk bëj sigurim, se të gjitha paditë që bëhn nuk bëhen me sigurim, ne që të mos kishte konflikte do bënim sigurimin kemi paguar paret nuk



na e ka bërë vullnetar njeri. Duke e marrë nga prokuroria duke ardhur dhe kallëzimi dhe duke thënë dhe prokuroria që nuk ka vepër penale atëherë bie vetë është paqësore janë konflikte të vogla që zgjidhen me pushtetin lokal. Pushteti lokal i juaj është kot... pse kapesht si Nastradini ajo sigurmi padisë. Thuaj ke bërë kallëzim zotëri padi gjyq? -Po. Je në proces gjyqësor? -Po. Nëse je i bindur që nuk po vazhdon gjyqi se gjyqi nuk mbahet me urdhrin tim se ka radhë atëherë ti thuaj na ke mashtruar nuk ke shkuar në gjykatë zotëri gjykata ty nuk të pranon. Më fal, çdo qytetar i Republikës së Shqipërisë ka të drejtë ska të drejtë bën padinë atje dhe mbaroi filmi, pastaj në fund jepet përfundimi. Po pra por ti më thua mua ajo e rrëzon vetë bie vetë kur nuk ka më fal agravim të çështjes bie vetë kjo punë. Jo hall ja ku është ky u kërcënuam se u zura me çunat e atij , u zura se u hodh çuni atij nga sipër rruga me disnivel toka atje 2m lart u hodh dhe më shajti nga familja që e kam kushëri çfarë duhet të bëja unë? Aty ishte dhe baba i atij kam bërë kallëzimin në polici çfarë doni ju ku doni ju kur të vriten njerëz? Po ik as fe as drej nuk keni ju, as ide.

Mitat Daja . Bashkia duhet t'i gjejë një zgjidhje urgjente kësaj pune.

Enver Gjini . Po të hap rrugën vetëm kaq asnjë lloj gjëje asnjë gjë nuk ka. Unë jam autokton jam dhe në atë të tërmetit u bë shtëpia, në qoftë se kjo nuk është shtëpia e babait tim ja ku jeni të gjithë këtu ja ku është shtëpia 150 vjeçare, prandaj i kam ruajtur dhe fotografitë pa ditur fare që do zihej drejt i rrugës ja ku është ja është ndërtuar shtëpia tjetër, ore po këtu është.

Hekuran Xhani . Nuk ka shtëpi që nuk ka kufijtë e vet, ju jeni bashki pa kufij kështu do i zgjidhni do i vritni njerëzit.

Enver Memolla . Ky është një problem që ka shumë ...dhe më parë e kam thënë që bashkia mund të bëjë një plan urbanistik për të mirën e banorëve? Që të jetë plan urbanistik dhe ta shpronësojë?

Enver Gjini . Këta nuk duan kanë zyrën bosh se këta nuk i kërkojnë kadastrës... zotërinjtë marrin taksat tona rrisin rrogat e veta.

Lulzim Hasa . Respekt për zotërinë hera parë që e dëgjoj, ai ka një kërkesë të ligjshme...

Tomorr Thartori . Quhet servitutit kalues e jep gjykata.

Lulzim Hasa . Nëse kjo tokë me 7501 e marrim sikur është në pronësi të atij për interes publik rruga hapet për varreza, për shtëpi, për shkollë e të gjitha quhet interes publik zhbllkohet. Dhe unë i them zotërisë vetëm kaq që Këshilli Bashkiak nuk mund ta shqyrtojë çështjen kur është në gjyq sepse ne nuk dalim mbi gjyqin.



Mitat Daja . E kam me Enkelën dhe me Tomin kur një rrugë e marrim si shembull sikur të gjithë ato që thonë ju kur një rrugë është shkelur për 30 vjet këto thonë që ka dhe më shumë ...

Enver Gjini . Jam 72 vjeç unë.

Mitat Daja . Po marr një shembull pra kjo rrugë ka 100 vjet që ekziston...

Silvana Aliu . 150.

Mitat Daja . Aq sa thonë nuk është problem. Ideja është që ekziston mundësia që ato harta të mos jenë të rregullta ... e kemi diskutuar me qindra herë dhe këto argumentet e juaja janë gjeni zgjidhje praktike gjyqi është çështje tjetër gjyqin e kanë banorët ...

Tomorr Thartori . Ligji thotë e jep gjykata ti thua ta japë bashkia?!

Enver Gjini . Mos e jep hajde liro rrugën. Është pronë shteti nuk është private kjo.

Tomorr Thartori . Ja ku është harta unë nuk po e mbaj fshehur ka rrugë shihe.

Enver Gjini . Ka pra rrugë ka.

Tomorr Thartori . Unë do e rregulloj? Hipoteka është problem hipoteke.

Hekuran Xhani . Mitat ka ardhur një punonjës i rendit aty ta dëgjojmë për respekt.

Lulzim Hasa . Zotëria kërkon një rrugë të kalojë për momentin derisa të merret vendimi i gjykatës. Ku do kalojë ky? Ti dhe gjithë të tjerët. Një rrugë edhe me marrëveshje të banorëve ndoshta dhe me fuqinë e shtetit të kalojë derisa të marrë formën e prerë. Forma e prerë e gjykatës pastaj as shteti as individi se ashtu dot, hajde me marrëveshje dhe ai që e ka bllokuar në dashtë dhe policia dhe pushteti të bien në marrëveshje derisa të merret vendim gjykate sepse po u mor vendim gjykate nuk ke çfarë i bën më, ku do shkojë ai. Ai thjeshtë do një rrugë derisa të merret vendimi i gjykatës të kalojë derisa të merret vendimi i gjykatës.

Hekuran Xhani . Rrugë alternative?

Lulzim Hasa . Jo jo rruga ekzistuese aty ku ka kaluar përherë.



Mitat Daja . Nuk pranon marrëveshje pala tjetër.

Lulzim Hasa . Të ndërhyjë shteti, ku do e çojë fëmijën në shkollë.

Astrit Thartori . Faleminderit zonja kryetare, faleminderit të nderuar anëtarë. Unë jam inspektori i zonës që e kam ndjekur me përparësi konfliktin midis familjeve që foli parafolësi por ne jmei të pafuqishëm për të vepruar sepse... dhe jo pa që llim ja kemi drejtuar këshillit bashkiak dhe bashkisë Rrogozhinë që të dalë me një vendim ku të kërkojë servitut kalimi për 7-familjet dhe 50 anëtarë që janë aty. Nga ana ligjore zotëria mund të ketë të gjithë të drejtën e Zotit por vendimi i gjykatës që kanë marrë zotërinjtë aty, kanë të drejtën e servitutit të kalimit për rrugën sepse nuk mund t'i ndërprehet asnjërit sepse kjo hyn dhe tek të drejtat dhe liritë e njeriut me një fjalë që ka të drejtë ta gëzojë pronën rrugën çdo gjë që ka krijuar Zoti. Dhe unë jam i mendimit ju si Këshill Bashkiak prandaj e kemi kërkuar këtë të merrni një vendim dhe të detyroni organet e pushtetit vendor që të veprojnë ne i kemi bërë procedurat i jemi drejtuar gjykatës prokurorisë për hetim. Ne kërkojmë nga këshilli bashkiak që të marrë një vendim që rruga të jetë e hapur për ato banorë derisa gjykata të shprehet me një vendim të formës së prerë. Nëse gjykata do shprehet me një vendim të formës së prerë, zyra e urbanistikës ka të drejtën që t'i gjejë rrugë banorëve, bashkia zyra e urbanistikës është struktura që merret me rrugët sepse të gjithë ato banorë që janë atje duhet të kenë akses për kalim. Dhe prandaj është bërë problem shqetësues disa herë kemi çuar në prokurori për ndjekje penale dhe prokuroria e ka pushuar çështjen. Kërkoj nga këshilli bashkiak që të marrë një vendim për servitut kalimi të banorëve të atyre famiuljeve që kalojnë atje, kaq kërkojmë ne, pastaj anën ligjore dhe procedurale do ta ndjekim ne në rrugë ligjore në prokurori dhe gjykatë. Të ketë servitut kalimi derisa të shprehet gjykata. Vendimi të dalë të vi dhe ne të bëjmë veprimet tona, zotëria nëse ka shkelur ligjin pastaj të përballet me policinë.

Lulzim Hasa . Nuk merret vendim në proces gjyqësor del mbi gjykatën ti këtu.

Fatmira Thartori . Ne kemi një komision për pronat, deri në momentin që jepet zyrtarisht masa ligjore nga gjykata, ne marrim një vendim të përkohshëm dhe bie poshtë e jona pastaj kur të dalë vendimi i gjykatës.

Mitat Daja . Enkela po më dëgjon? Atëherë ne sot mund të marrim një vendim për hapje rruge të përkohshme derisa ta zgjidhi konfliktin gjykata? Pyes se prevalon e drejta e njerëzve për të jetuar sepse ata kanë nevoja jetese do i shkojë ambulanca do i shkojë makina për të shkuar në shtëpi dmth prevalon e drejta e jetës me këtë lloj gjykimi deri kur këta të marrin...



Enkela Ballabani . Një pyetje për z. Enver, a është shprehur gjykata në lidhje me sigurimin e padisë në padinë objekt? Se është çështja këtu në monetin që ju keni bërë një kërkesë për sigurim padie duhet të shprehet gjykata nëse ajo rrugë duhet të rri e lirë deri në momentin sa të merret vendimi i formës së prerë.

Enver Memolla . Kryetare tani propozimin hidhe në votim për lirimin e rrugës derisa të shprehet gjykata.

Mitat Daja . Hidhe në votim.

Mukades Gixhari . Atëherë jeni dakord ta hedhim në votim për lirimin e rrugës derisa të dalë vendimi nga gjykata?

Mitat Daja . Atëherë të marrim një vendim për hapjen e rrugës derisa gjykata të shprehet në formë të prerë.

Mukades Gixhari . Po pra por votimin do ta bëjë komisioni i zgjidhjes së konflikteve. E hedhim në votim. Jeni dakord? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 vota pro, projektvendimi i propozuar nga Komisioni për çështjet juridike, rend, konflikte, “Për lejimin e përdorimit (aksesit) të rrugës së kalimit në lagjen nr.1, mbi stacionin e trenit Rrogozhinë nga banorët e lagjes” .

Vendim nr.7, Miratohet me 12-vota pro, projektvendimi projektvendimi i propozuar nga Komisioni për çështjet juridike, rend, konflikte, me Nr.846.Prot datë 25.02.2025 “Për lejimin e përdorimit (aksesit) të rrugës së kalimit në lagjen nr.1, mbi stacionin e trenit Rrogozhinë nga banorët e lagjes” , si dhe Relacioni shpjegues për këtë projektvendim me Nr.846/1.Prot datë 25.02.2025 .

Mukades Gixhari . Tek të ndryshmet jemi.

Hekuran Xhani . Enver sa sipërfaqe zë kjo rrugë?

Enver Gjini . Ai pretendon 17.5 m².

Hekuran Xhani . Sa metra është kjo rrugë?

Enver Gjini . Rruga është 136 metra shteti.



Hekuran Xhani . Katrorë? Për të zgjidhur një konflikt dhe për të hapur një servitut nuk është ndonjë sipërfaqe e madhe ta shpronësojë edhe bashkia të hapet rruga.

Enver Gjini . Është në proces gjyqësor edhe bashkia të rrijë rehat

Hekuran Xhani . Ta shpronësojë bashkia në fund të fundit.

Mukades Gixhari . Ndonjë gjë tjetër, diskutim tjetër?

Enkela BallabaniProcedurës së tenderimit se në protestën që keni bërë para disa ditësh , që të sqaroj si këshilltarët edhe personat . Përsa i përket procedurës së tenderimit për rrugën në Rrostej ose të gjithë pjesën e Sinaballaj që parashikohet për t'u rindërtuar për t'u bërë rrugë është bërë njoftimi i shkurtuar i kontratës më datë 11.11.2024 është publikuar ky njoftim në buletin nr.80, datë 18.11.2024. Është bërë hapja e ofertave në sistem nga komisioni i vlerësimit të ofertave me datë 02.12.2024 dhe më pas është marrë vendimi i klasifikimit të ofertës me datë 10.12.2024 është bërë formulari i fituesit paraprak sipas vendimit të vlerësimit të KVO. Është bërë më pas formulari i fituesit përfundimtar dhe është bërë lidhja e kontratës me datë 08.01.2025 dhe pas kësaj është bërë formulari i njoftimit të kontratës që është hedhur në SPE me datë 14.01.2025. Përsa i përket asaj deklaratës tuaj që keni bërë në një media dua të të njoftoj z. Indrit Dedeji se drejtoresha juridike qoftë dhe si kryetare e njësisë së prokurimit e ka përfunduar detyrën e saj me lidhjen e kontratës bashkë dhe gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, kanë kryer detyrën për sa i përket tenderit që është dhënë me urdhër të kryetarit të bashkisë dhepërgjegjësia jonë ligjore për sa i përket detyrimit për tenderin është përfunduar dhe është mbyllur ai kapitull. Ne nuk kemi asnjë përgjegjësi për sa i përket zbatimit të kontratës sepse është një sektor tërësisht tjetër në bashki që merret me zbatimin e projekteve dhe me zbatimin e kontratave për sa i përket investimve që bën bashkia në lidhje me projektet këtë doja ta sqaroja. Përsa i përket kontratës kam kontratën origjinale është lidhur kjo kontratë origjinale me firmën fituese IDEAL-CONSTRUCTION & PROJECT SHPK e cila është bashkim operatrësh me BALILI CONSTRUCTION SHPK me datë 08.01.2025 dhe për ne ky tender dhe për mua si kryetare e njësisë së prokurimit ka përfunduar është në sistem është komplet i rregullt me procedura të rregullta ligjore me një dosje të plotë për sa i përket procedurës që do merret dhe do rishikohet qoftë nga KLSH-ja për sa i përket gjithë rregullsisë së procedurës. Po përgjegjësia jonë ligjore për sa i përket zbatimit të kontratës nuk na përket ne se i takon drejtorisë së urbanistikës, të cilët kanë dhe një sektor të posaçëm që merret me zbatimin e projekteve. Unë doja të sqaroja përgjegjësinë time për aq kohë sa kishe përmendur drejtoreshën juridike.

Indrit Dedej . Ti më thua mua do të jap kontratën nga ajo që nuk e dhe kontratën ike ne po pritnim.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

Enkela Ballabani . Kam ikur se atë ditë kam marrë lejen vjetore.

Enver Memolla . Kryetare nuk ka kuorum.

Mukades Gixhari . Z. Indrit ta mbyllim dhe e vazhdojmë. Meqë nuk e kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 14 : 20^{oo} . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 1 orë ; 55 min ; 58 sek. I ndarë në dy video, e para : 1 orë ; 00 min ; 49 sek dhe video e dytë : 55 min e 09 sek.
- Ky procesverbal mbyllet në faqen 25 (njëzet e pesë).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

Sekretari i Këshillit

Ervis Shera